



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 606 Prot.

Tiranë, më datë 26.12.2018

**VENDIM**

**Nr. 524, datë 26.12.2018**

**PËR**

**VAZHDIMIN E PROCEDURAVE TË LEGALIZIMIT**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me V.K.M. Nr. 756, datë 26.10.2016, si dhe Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 26.12.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e vazhdimit të procedurave të legalizimeve për objektin: “Shtesë në lartësi në objektin ekzistues në qendrën historike të fshatit të Kaninës, me aplikues Nevzat Eduard Zyberi”;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR I KKR**

**Arta Dollani**

**KRYETAR**

**Mirela KUMBARO FURXHI**

